



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 16.

Prishtinë, më 16.09.2011 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Mungon: Petar Miletic

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI-Besnik Ramadani, përfaqësuesi i KKK-Veton Berisha, përfaqësuesi nga Presidenca-Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës.**
2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së datës 26.08 dhe 29.08.2011**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurit e tyre, me raportin e Komisionit funksionale për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për nisme legislative, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.**
5. **Të ndryshme**

***Kryesuesi** - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Krzesuesi** - konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar.

***Kryesuesi** – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjes të datës 26.08.2011 dhe të datës 29.08.2011, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurit e tyre, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë. Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurit e tyre, të propozuara nga Komisioni Funksional. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurit e tyre, dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për nisma legislative, me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për nisma legislative, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për nisma legislative, dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic